



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në pajtim me nenin 48, paragrafi (1), pika 3) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10 dhe 123/13) dhe pikë 13) të Vendimit të përmbajtjes dhe të mënyrës së funksionimit të Regjistrit të Kredisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 186/13), guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

Udhëzim
për zbatimin e Vendimit të përmbajtjes dhe të mënyrës së funksionimit të
Regjistrit të Kredisë
(Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 14/14)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzues përcaktohen lloji, mënyra dhe afatet e dorëzimit dhe përdorimit të të dhënave dhe informatave deri te/nga Regjistri i Kredisë nga ana e bankave dhe kursimoreve në Republikën e Maqedonisë.

2. Për shkak të zbatimit të Vendimit të përmbajtjes dhe mënyrës së funksionimit të Regjistrit të Kredisë (në tekstin më tutje: Vendim), Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin më tutje: Banka Popullore) vendos veb-aplikacion të veçantë dhe shërbim interneti – Regjistri i Kredisë (në tekstin më tutje: Aplikacion).

Termat që janë të definuara në Vendimin përdoren me kuptimin e njëjtë edhe në këtë udhëzues.

II. MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË APLIKACIONIT

3. Aplikacioni punon në mjedis-interneti me qasje të kufizuar të rrjetit kompjuterik dhe bazën e të dhënave.

4. Aplikacioni është i qasshëm për bankat dhe kursimoret për qëllimet e definuara në Vendim.

5. Bankat dhe kursimoret dorëzojnë të dhëna dhe informata në pajtim me instruksionet teknike për punë me aplikacionet e Bankës Popullore.

III. LLOJI, MËNYRA DHE AFATET E DORËZIMIT DHE TË PËRDORIMIT TË TË DHËNAVE DERI TE/NGA REGJISTRI I KREDISË

6. Të dhënat dhe informatat sipas pikës 4) të Vendimit të cilat bankat dhe kursimoret janë të detyruara t'i dorëzojnë Regjistrin të Kredisë janë të përcaktuar në:

- Shtojcën nr. 1 – Lista e të dhënave hyrëse;
- Shtojcën nr. 2 – Shifra për tregtarët në pakicë;

- Shtojcën nr. 3 – Shifra për qëllimin e kredive të personave fizikë/popullsinë;
- Shtojcën nr. 4 – Shifra për llojin e sigurimit;
- Shtojcën nr. 5 – Shifra për komunat.

Shtojcat e kësaj pike janë pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi.

Bankat dhe kursimoret i dorëzojnë të dhënat dhe informatat nga paragrafi (1) i kësaj pike me përdorimin e shifrave të definuara në shtojcat përkatëse.

Të gjitha të dhënat që dorëzohen Regjistrin të Kredisë, ndërsa kanë të bëjnë me shumat, përkatësisht vlerat, janë të shprehura në mijëra denarë.

7. Bankat dhe kursimoret janë të detyruara t'i dorëzojnë të dhënat dhe informatat e pikës 4) të Vendimit në Regjistrin e Kredisë, në bazë mujore, me gjendje në fund të muajit për të cilin njoftohet.

Të dhënat dhe informatat nga paragrafi (1) të kësaj pike dorëzohen në periudhën nga 1. deri në 15. në muajin tjetër.

Me përjashtim të paragrafit (2) të kësaj pike, të dhënat dhe informatat, me gjendjen e 31 dhjetor dorëzohen nga 25 janar deri në 5 shkurt.

8. Bankat dhe kursimoret mund t'i përdorin këto të dhëna dhe informata të agreguara nga Regjistri i Kredisë:

- Titulli i personit juridik, përkatësisht, emri dhe mbiemri i personit fizik;
- Shuma e përgjithshme dhe struktura e ekspozimit kreditor të të gjitha bankave dhe kursimoreve për një klient të veçantë;
- Numri i përgjithshëm i bankave dhe kursimoreve që janë të ekspozuar ndaj rrezikut kreditor nga klient i veçantë;
- Numri i përgjithshëm i partive kreditore;
- Shuma e përgjithshme e korigjimit të kryer të vlerës, përkatësisht rezerva e veçantë e ndarë e të gjitha bankave dhe kursimoreve për klient të veçantë;
- Të dhënat e sigurimit;
- Shuma e përgjithshme e kredive të rifinancuara;
- Shuma e përgjithshme e kredive të ristrukturuara;
- Numri maksimal i ditëve të vonësës në plotësimin e obligacioneve dhe shumën përkatëse;
- Shuma e përgjithshme e ekspozimit për të cilin është garant (në qoftë se klienti është garant) në datën për të cilën njoftohet;
- Qëllimi i ekspozimit ndaj klientit – personit fizik;
- Shuma e përgjithshme e kërkesave të paraqitura të çregjistruara;
- Të dhëna dhe informata të tjera.

9. Banka Popullore mundëson qasje te të dhënat dhe informatat të Regjistrin të Kredisë sipas pikës 8) të këtij udhëzuesi, në afat prej 7 (shtatë) ditë pune pas skadimit të afateve të parashikuara në pikën 7) të këtij udhëzuesi.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

10. Me fillimin e zbatimit të këtij udhëzuesi, shfuqizohet Udhëzuesi për zbatimin e Vendimit për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 139/11).

11. Ky udhëzues hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, ndërkaq do të fillojë të zbatohet për të dhënat me gjendjen e 31 dhjetorit 2013.

Pas përjashtimit të paragrafit (1) të kësaj pike, obligimi për dorëzimin e të dhënave nga rreshtat 11-1, 11-2, 12-a, 13-a, 14-a, 15-a, 24-1, 24-a-1, 24-6, 27-1, 29-1, 33-a dhe 41-1 nga shtojca nr. 1 dhe të dhënat për shifrat për llojin e sigurimit 018 dhe 019 nga shtojca nr. 4 të këtij udhëzuesi, do të fillojë të zbatohet nga 1 dhjetori I vitit 2014.

Obligimi për dorëzimin e të dhënave nga rreshtat 11, 24, 24-a, 27, 29 dhe 41 nga shtojca nr. 1 të këtij udhëzuesi do të vlejë deri në 30 nëntor 2014 (për të dhënat me gjendjen e 30 nëntorit 2014).

U nr. 1890
22 janar 2014
Shkup

Guvernatori
Димитар Богов

Shtojca nr. 1

Lista e të dhënave hyrëse

Nr.re ndor	Emri i fushës	Përshkrimi i fushës	Plotësimi i detyrueshëm
1	2	3	
1	Tipi	Kodi i tipit "klienti": 01 – personi juridik. Vendoset çdo person juridik. 02 – personi fizik*. Vendoset çdo person fizik. 03 - Popullsia**. Vendoset numri i përgjithshëm i të gjitha partive kreditore të personave fizikë nën limitin e përcaktuar me Vendimin, të ndarë sipas kategorisë së rrezikut, valutës, qëllimit dhe llojit të korigjimit të vlerës/rezervës së veçantë. 04 - personat juridikë **. Vendoset numri i përgjithshëm i të gjitha partive kreditore të personave juridikë dhe i klientëve të tjerë (08), nën limitin e përcaktuar me Vendimin, të ndarë sipas kategorisë së rrezikut, valutës, aktivitetit të përgjithshëm dhe llojit të korigjimit të vlerës/rezervës së veçantë. 05 - tregtarët në pakicë **. Vendoset numri i përgjithshëm i të gjitha partive kreditore të tregtarëve në pakicë, nën limitin e përcaktuar me Vendimin, të ndarë sipas kategorisë së rrezikut, valutës, qëllimit dhe llojit të korigjimit të vlerës/rezervës së veçantë. 06 - Bankat. Vendoset çdo bankë. 07 - institucione financiare jobankare. Vendoset çdo institucion financiar jobankar. 08 - Klientë të tjerë (Literatura udhëzuese: Udhëzuesi për klasifikim sipas sektorëve institucionale: qeveria qendrore, vetëqeverisje lokale, fonde për sigurim social, institucione joprofitabile që i shërbejnë amvisërive). 09 - tregtarët në pakicë. Vendoset çdo person*.	Po

		* një person i njëjtë mund të jetë i paraqitur edhe si person fizik, edhe si tregtarë në pakicë, varësisht nëse kredinë e përdor si person fizik ose për aktivitet biznesi. ** Vërejtje: shuma e përgjithshme për tipat 03 - popullsi, 04 – personat juridikë dhe 05 – tregtarë në pakicë, nuk duhet të tejkalojë 5% nga shuma e ekspozimit kreditor.	
2	Rez	Kodi i rezidentit (R) / jorezidentit (J)	Po
3	Kod	Kodi i identifikimit unik në RM: Numri amëz: për person juridik dhe tregtar në pakicë. NVAQ: për person fizik -rezident. ‘0000000000001’ për shumën e përgjithshme “popullsi”. ‘0000000xxxxx2’ për shumën e përgjithshme “personat juridikë”(xxxxx është veprimtari pagesore e grupit; shembull, për “veprimtari” = 02 vendoset ‘0000000020002’). ‘0000000000003’- për shumën e përgjithshme “tregtarë në pakicë”. Kodi i personit juridik jorezident. Procedura e vendosjes së kodit: kodi i shtetit (2 shenja) + numri i vetëm amzë (ID) në shtetin amë (pa shenja speciale); shembull: IT4064488. Kodi i personit fizik jorezident. Procedura e vendosjes së kodit: kodi i shtetit (2 shenja) + numri i pasaportës (pa shenja speciale); shembull: IT235617G8. Kodi i bankave të huaja. Procedura e vendosjes së kodit: kodi i shtetit (2 shenja) + kodi SVIFT i bankës së huaj.	Po
4	Numri tatimor	Numri i tatimit për personat juridikë rezidentë.	Vetëm për tipat = 01, 06, 07, 08 dhe 09.
5	Titulli	Titulli i personit juridik.	Po, përveç për tipin = 02. Për tipin = 09 kjo fushë plotësohet vetëm për tregtarët individualë me veprimtari të regjistruar. Për tipat = 03, 04 dhe 05 vendoset përshkrim (popullsi,

			persona juridikë, tregtarë në pakicë).
6	Emri	Emri i personit fizik.	Vetëm për tipat = 02 dhe 09.
7	Mbiemri	Mbiemri i personit fizik.	Vetëm për tipat = 02 dhe 09.
8	Qyteti	Komuna në pajtim me shtojcën nr. 5.	Vetëm për rezidentët. Për tipat = 03, 04 dhe 05 kjo fushë nuk plotësohet.
9	Shteti	Shteti	Po
10	Veprimtaria	Veprimtaria kryesore të personat juridikë (vendoset së paku kodi katërshifror i veprimtarisë në pajtim me Vendimit për marrjen e klasifikimit nacional të veprimtarive – KNV Rev. 2).	Vetëm për tipat = 01, 04, 06, 07 dhe 08.
11	nrPK	Numri i partisë kreditore , çdo bankë e shfaq në formatin e saj. Në qoftë se në kornizë të partisë së njëjtë kreditore ka kërkesa të shprehura në valuta të ndryshme, atëherë paraqitet numri i njëjtë i partive kreditore me shtimin e shenjës "/x". Për shembull për kryegjënë në denarë me klauzolë devizore do të paraqitet "numri i partisë kreditore /1", për provizionin në denarë do të paraqitet "numri i partisë kreditore /2" etj. Kjo fushë plotësohet përfundimisht deri në 30 nëntor 2014.	Po
11-1	nrPK	Numri i partisë kreditore , çdo bankë e shfaq në formatin e saj. Në qoftë se në kornizë të partisë së njëjtë kreditore ka kërkesa të shprehura në valuta të ndryshme ose pjesë të partisë kreditore është e siguar me depozitë të parave që i plotëson kushtet e definuara në pikën 24), nën-pikën 24.1) të Vendimit të metodologjisë për menaxhim me rrezikun kreditor, atëherë paraqitet numri i njëjtë i partisë kreditore me shtimin e shenjës "/x". Shembulli 1, për kryegjënë në denarë me klauzolë devizore do të paraqitet "numri i partisë kreditore /1", për provizionin në denarë do të paraqitet "numri i partisë kreditore /2" etj. Shembulli 2, për partinë kreditore e cila është pjesërisht e siguar me depozitë të parave, për pjesën e siguar me depozitën e parave do të paraqitet "numri i partisë kreditore /1", ndërsa për pjesën e pasiguar të partisë kreditore me depozitën e parave do të paraqitet "numri i partisë kreditore /2" etj.	Po

11-2	nrPVK	Numri i partive të vjetra kreditore. Në qoftë se gjatë ristrukturimit (R), vazhdimi të afatit të skadimit (V)***, konsolidimit ose rifinancimeve të tjera (K)****, banka e miraton parti kreditore me numër të ri, në atë rast në këtë fushë shënohen numrat e partive kreditore që janë të përfshira me ristrukturimi, vazhdimi i afatit të skadimit (për shembull: numri i partisë së vjetër kreditore / numri i partisë së vjetër kreditore / numri i partisë së vjetër kreditore etj.). Kjo fushë plotësohet deri në 1 dhjetor 2014 për ekspozimet kreditore të cilët është bërë rikonstruimi, vazhdimi i afatit të skadimit, konsolidimi ose rifinancime të tjera nga 1 dhjetor 2014. *** Vërejtje: Në tekstin më tutje të kësaj shtojce me vazhdimin e afatit të skadimit nënkuptohet vazhdimi i afatit të maturimit në pajtim me pikën 2), nënpika 2.10), alinea 2) të Vendimit për menaxhim me rrezikun kreditor. **** Vërejtje: Në tekstin më tutje të kësaj shtojce me konsolidimi ose rifinancime të tjera nuk nënkuptohen rifinancimet në pajtim me pikën 2), nënpika 2.10), alinea 3) të Vendimit për menaxhim me rrezikun kreditor.	Po, përveç për përjashtimet e parapara në kolonën 3.
12	tipRK	A - anuitet; E – i njëhershëm (inkuadrohen edhe ekspozimet që dalin prej një partie kamatore, për shembull: provizioni); K – kartela të kamatës dhe llogarita aktuale.	Po, përveç për tipat= 03, 04 dhe 05.
12-a	ShumëA	Shuma e anuitetit. Vendoset shuma e anuitetit në datën e njoftimit. Kjo fushë plotësohet për të gjithë ekspozimet kreditore për të cilat fusha 12 (tipi RK) është A.	Po, përveç për tipat= 03, 04 dhe 05.
13	Data 1miratimit	Data e daljes së parë të parave. Në qoftë se bëhet fjalë për ekspozimit të cili nuk ka dalje të parave (garanci, akreditiv), ekspozimi në bazë të tejkalimeve të lejuara, kartela kreditore e ngjashme, vendoset data e lidhjes së kontratës. Kjo fushë nuk plotësohet në rastin e konsolidimit të më shumë partive kreditore. Kjo fushë nuk plotësohet (e zbrazët) nëse ekspozimi është vetëm në bazë të kamatës dhe/ose të provizionit. Kjo fushë nuk është e detyrueshme nëse ekspozimi është vetëm në bazë të mjeteve	Po, përveç për tipat= 03, 04, 05 dhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.

		të pa maturuara dhe depozitave brenda natës te bankat.	
13-a	datëR/V/K	Data e ristrukturimit ose e vazhdimi të afatit të skadimit, konsolidimit ose refinancimet e tjera. Vendoset data e ristrukturimit (datR) ose e vazhdimi të afatit të skadimit (datV), konsolidimit ose refinancimet e tjera (datëK). Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014 për ekspozimet kreditore të cilët është bërë rikonstruimi, vazhdimi i afateve të skadimit, konsolidimi ose refinancimet e tjera nga 1 dhjetor 2014.	Po, përveç për tipat= 03, 04, 05 dhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
14	RKmiratuar	Shuma e miratuar e ekspozimit (kredi, garanci, akreditiv, kredi kornize, kartelë kreditore e ngjashme) gjatë miratimit të parë. Për ekspozimin jashtë bilancit vendoset shuma e kontraktuar. Kjo fushë nuk plotësohet në raste të konsolidimit të shumë partive kreditore. Kjo fushë nuk plotësohet nëse ekspozimi përbëhet vetëm nga kërkesa të tjera dhe/ose kamatë. Kjo fushë nuk është e detyrueshme nëse ekspozimi përbëhet vetëm nga mjete të pa maturuara dhe depozita brenda natës te bankat.	Po, përveç për tipat= 03, 04, 05 dhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
14-a	miratimiR/V/K	Shuma e miratuar gjatë ristrukturimit (miratimiR), vazhdimi i afatit të skadimit (miratimiV), konsolidimi ose refinancime të tjera (miratimiK). Vendoset shuma e ekspozimit kreditor të datës së ristrukturimit, vazhdimi të afatit të skadimit, konsolidimit ose refinancimit tjetër. Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014 për ekspozimet kreditore të cilët është kryer rikonstruimi, vazhdimi i afatit të skadimit, konsolidimit ose refinancimit tjetër nga 1 dhjetor 2014.	Po, përveç për tipat= 03, 04, 05 dhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
15	data e skad. e krye	Data e fundit e skadimit të ekspozimit. Vendoset data e fundit të skadimit të partisë kreditore, sipas kontratës. Për ekspozimit në bazë të garancive, akreditivave, kartelave kreditore, llogarive aktuale dhe produkteve të ngjashme, në këtë pozicion vendoset afati i vlefshmërisë. Gjatë pagesës së anuitetit, vendoset data e skadimit të anuitetit të fundit. Në raste kur nuk ka datë e skadimit (shemb. Ekspozim vetëm në bazë të provizionit) dhe/ose nëse ekspozimi përbëhet vetëm nga kamata, kjo fushë nuk plotësohet (zbrazët).	Po, përveç për tipat= 03, 04, 05 dhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.

		Kjo fushë nuk është e detyrueshme nëse ekspozimi përbëhet vetëm nga mjete të pamaturuara dhe depozita brenda natës te bankat.	
15-a	datKrye	Data e skadimit të parë të kryegjësë. Vendoset data e skadimit të obligacionit të parë të pagesës së kryegjësë (anuiteti i parë ose data e skadimit të grejs-periudhës). Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014 për ekspozimet kreditore të miratuara nga 1 dhjetor 2014, për të cilat fusha 12 (tipiKR) është A ose për të cilat është e miratuar pagesë e shtyrë të kryegjësë.	Po, përveç për tipat= 03, 04, 05 dhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
16	Kryerregullt (1)	Kryegjëja e rregullt – e pamaturuar. Vendoset shuma e kryegjësë së pamaturuar në fund të periudhës për të cilin njoftohet. Vendoset shuma-bruto, duka mos marrë parasysh shumën e korrjigimit të vlerës dhe të amortizimit të akumuluar.	Po
17	изДостГлав (2)	Kryegjëja e rregullt – e maturuar. Vendoset shuma e kryegjësë së maturuar, në fund të periudhës për të cilin njoftohet. Vendoset shuma-bruto, duke mos marrë parasysh shumën e korrjigimit të vlerës dhe të amortizimit të akumuluar.	Po
18	Kamataerre gullt (3)	Kamata e rregullt. Vendoset shuma e kamatës (e rregullt, e maturuar dhe e pamaturuar) në fund të periudhës për të cilin njoftohet.	Po
19	kryejofunk. (4)	Kryegjëja jofunksionale. Vendoset shuma kryegjësë jofunksionale në fund të periudhës për të cilin njoftohet. Vendoset shuma-bruto, duke mos marrë parasysh shumën e korrjigimit të vlerës dhe të amortizimit të akumuluar.	Po
20	Kamjofunk. (5)	Kamata jofunksionale. Vendoset shuma e kamatës jofunksionale në fund të periudhës për të cilin njoftohet.	Po
21	kërkesatëtj era (6)	Kërkesa të tjera. Се внесува износот на другите побарувања në fund të periudhës për të cilin njoftohet.	Po
22	Normjasht (7)	Normat jashtë bilancit. Vendoset shuma e pozicioneve jashtë bilancit на крајот на периодот за кој се известува	Po
23	Ekspipërgjith. h.	Ekspozimi i përgjithshëm: përmbledhja e shumave të fushave 16, 17, 18, 19, 21 dhe 22.	Po
24	maksDV	Numri maksimal i ditëve të vonesës (të vonesës më të gjatë). Kjo fushë plotësohet përfundimisht me 30 nëntor 2014.	Po, përveç për tipat= 03, 04 dhe 05.
24-1	maksDVKGj /K/B	Numri maksimal i ditëve të vonesës të datës së njoftimit, siç është:	Po, përveç për tipat= 03, 04 dhe 05.

		((maksDVKGj) për kryegjënë; (maksDVK) për kamatën; (maksDVB) për kërkesa të tjera. Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014.	
24-a	shumëDV	Vendoset shuma e cila ka të bëjë me numrin maksimal të ditëve të vonesës. Kjo fushë plotësohet përfundimisht me 30 nëntor 2014.	Po, përveç për tipat= 03, 04 dhe 05.
24-a-1	shumëDVK Gj/K/B	Vendoset shuma e cila ka të bëjë me numrin maksimal të ditëve të vonesës të datës së njoftimit, siç është: (shumë DVKGj) për kryegjënë; (shumë DVK) për kamatën; (shumë DVB) për kërkesa të tjera. Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014.	Po, përveç për tipat= 03, 04 dhe 05.
24-b	RK	Pagesa e obligacioneve në datën e njoftimit. Vendoset: (RK 1) nëse pagesat (pjesërisht ose tërësisht) i kryen garanti; (RK2) nëse paguani (pjesërisht ose tërësisht) i kryen personi tjetër në bazë të kontratës së lidhur për qasje ndaj borxhit; Në të gjitha raste të tjera të pagesës së obligacioneve, kjo fushë nuk plotësohet. Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014.	Po, përveç për tipat= 03, 04 ,05 edhe për përjashtimin e parashikuar në kolonën 3.
25	SHK	Shkallë e kamatës , përkatësisht përqindja e shkallës nominale të kamatës (në nivel vjetor), e vlefshme në datën për të cilin dorëzohen të dhënat, e përfaqësuar me një decimal. Kjo fushë nuk plotësohet për normat jashtë bilancit dhe për kërkesa të tjera (0.0).	Po, përveç për tipat= 03, 04 ,05 edhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
26	tipSHK	Tipi i shkallës së kamatës sipas kontratës së lidhur: (F) shkallë fikse e kamatës, e cila është e pandryshueshme; (P) shkallë e përshtatshme e kamatës, e cila ndryshohet sipas vendimit të organit kompetent të bankës; (N) shkalla e ndryshueshme e kamatës, e cila ndryshohet varësisht nga lëvizshmërisë së shkallës së përcaktuar të kamatës referente. Plotësimi i kësaj fushe nuk është e detyrueshme në qoftë se ekspozimi përbëhet vetëm nga kërkesa të tjera, norma jashtë bilancit ose kamata jofunksionale.	Po, përveç për tipat= 03, 04 ,05 edhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
27	R/V	Ristrukturimi ose vazhdimi i afatit të maturimit të partisë kreditore, siç është: (R) restrukturimi; (V) vazhdimi i afatit të maturimit në pajtim me pikën 2), nënpikë 2.10), aline 2) të Vendimit të menaxhimit me rrezikun kreditor;	Po, përveç për tipat= 03, 04 ,05 edhe për përjashtimin e parashikuar në kolonën 3.

		Në qoftë se nuk është kryer ristrukturimi ose vazhdimi i afatit të maturimit, kjo fushë nuk plotësohet. Kjo fushë plotësohet përfundimisht me 30 nëntor 2014.	
27-1	R/V/F/K	Ristrukturimi, vazhdimi i afatit të skadimit, miratimi i ekspozimit kreditor për pagesë bankës tjetër, konsolidimi ose refinancimi tjetër, siç është: (R) ristrukturimi; (V) vazhdimi i afatit të maturimit në pajtim me pikën 2), nën pikë 2.10), aline 2) të Vendimit të menaxhimit me rrezikun kreditor; (F) miratimi i ekspozimit kreditor për pagesë bankës tjetër, në pajtim me pikën 2), nën pikë 2.10), aline 2) të Vendimit të menaxhimit me rrezikun kreditor; (K) Konsolidimi i më shumë kërkesash në pajtim me pikën 2), nën pikë 2.10), aline 2) të Vendimit të menaxhimit me rrezikun kreditor ose refinancime të tjera në pajtim me pikën 2), nën pikë 2.10), aline 2) të Vendimit të menaxhimit me rrezikun kreditor të cilët nuk janë të përfshirë me shenjë (V). Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014, ku shenjat (F) dhe (K) vendosen për ekspozimet që janë të refinancuara nga 1 dhjetor 2014. Në qoftë se nuk është kryer ristrukturimi ose vazhdimi i afatit të skadimit, miratimi i ekspozimit kreditor për pagesë bankës tjetër, konsolidimi ose refinancimi tjetër, kjo fushë nuk plotësohet.	Po, përveç për tipat= 03, 04 ,05 edhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
28	nrR/V	Numri i vazhdimeve në afatin e maturimit/numri i ristrukturimeve. Në qoftë se nuk është kryer asnjë vazhdim të afatit të maturimit / ristrukturimi i ekspozimit kreditor edhe për tipat = 03, 04 dhe 05, vendoset 0.	Po
29	Data e re e maturimit	Data e maturimit të ekspozimit, pas vazhdimit të kryer të afatit të skadimit/ristrukturimi, në pajtim me rregullat e fushës 15 (dataemat.ekryegjë). Kjo e dhënë vendoset vetëm nëse është kryer vazhdimi i afatit të maturimit/ristrukturimit (në të kundërtën, kjo fushë mbetet e zbrazët). Kjo fushë plotësohet përfundimisht me 30 nëntor 2014.	Po, vetëm në rastet kur fusha 27 është R ose V dhe fusha 28 >0.
29-1	Data e re e maturimit	Data e re e maturimit të ekspozimit në pajtim me rregullat e fushës 15	Po, vetëm në rastet kur fusha 27-1 është R ose

		(dataematekryegjë), pas rishikimit të kryer, vazhdimi i afatit të skadimit, konsolidimi ose rifinancimi tjetër. Kjo e dhënë vendoset vetëm nëse është ndryshuar data e skadimit të ekspozimit kreditor në të kundërtën, kjo fushë mbetet e zbrazët). Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014 për ekspozimet kreditore të cilët është kryer rishikimi, vazhdimi i afatit të skadimit, konsolidimi ose rifinancimi tjetër nga 1 dhjetor 2014.	V dhe fusha 28 >0, ose nëse fusha 27-1 është K dhe është bërë shkurtimi i afatit të skadimit të kërkesës.
30	Përq.ekorri gjReze veçantë	Përqindja e korigjimit të kryer të vlerës dhe rezerva e veçantë e ndarë. Vendoset numri decimal nga 0 deri në 100 me 1 vend decimal.	Po
31	ShumKorrij RezVeç	Shuma e korigjimit të vlerës dhe rezerva e veçantë.	Po
31-a	LlojKorrijRe zVeç	Lloji i korigjimit të vlerës/rezerva e veçantë G- për korigjim të vlerës/rezerva e veçantë, përkatësisht humbja e pritshme kreditore në bazë grupi për portfolion e kredive; P - për korigjim të vlerës/rezerva e veçantë, përkatësisht, humbja e pritshme kreditore në bazë individuale; PG – për korigjim të vlerës/rezerva e veçantë për një grup instrumentesh të ngjashme financiare.	Po
32	Val	Valuta e kodit të shifrave të Bankës Popullore për valuta. Vendoset valuta në të cilën kredia është i miratuar.	Po
33	ValTipKr	Valuta e kodit të shifrave të Bankës Popullore për valuta. Me anë të kombinimit të vlerave të kësaj fushe dhe nga fusha numër 32, përcaktohet struktura valutore e ekspozimit (denarë, deviza ose në denarë me klauzolë devizore).	Po
33-a	qëllDev	Qëllimi i kredisë në deviza. Gjatë plotësimit të kësaj kolone përdoren shifrat: PJV – Kredi në deviza për pagesë jashtë vendit; PV – Kredi në deviza për pagesë në vendin. Kjo fushë plotësohet për punët e lidhura kreditore në deviza me rezidente në pajtim me rregullativën nënligjore të Bankës Popullore, për kushtet dhe mënyrën nën të cilat rezidentët mund të lidhin punë kreditore në deviza dhe të bëjnë pagesë në bazë të atyre punëve kreditore.	Vetëm për punët e kontraktuara kreditore në deviza me rezidente.

34	qëllimi	Qëllimi i kredisë të personat fizikë dhe tregtarët në pakicë (në pajtim me shtojcën nr. 2 dhe shtojcën nr. 3).	Po vetëm për tipat, = 02, 03, 05 dhe 09.
35	Llojiisigur.	Lloji i sigurimit (në pajtim me shtojcën nr. 4). Për një parti kreditore mund të paraqiten më shumë sigurime. Njoftimi për shifrat 018 dhe 019 fillon nga 1 dhjetor 2014.	Po vetëm për tipat = 03, 04 dhe 05.
35-a	Rendi i sig	Rendi i sigurimit (i pari – vendoset 1, i dyti – vendoset 2). Kjo fushë nuk është e detyrueshme për shifrat e sigurimit nga 001 deri në 005 dhe nga 014 deri në 017. Njoftimi për shifrat 018 dhe 019 fillon nga 1 dhjetor 2014.	Po vetëm për tipat = 03, 04, 05 dhe për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
36	ShumeSig	Shuma e sigurimit. Nëse një lëndë e njëjtë përdoret si sigurimi i më shumë partive kreditore, atëherë shënohet vlera e sigurimit (pjesa) që ka të bëjë me partinë konkrete kreditore. Shuma e sigurimit nuk vendoset në raste kur lloji i sigurimit për ekspozim kreditor, në pajtim me shtojcën nr. 4 të këtij udhëzuesi, ka shifër 014 dhe 015. Njoftimi për shifrat 018 dhe 019 fillon nga 1 dhjetor 2014.	Po vetëm për tipat = 03, 04 dhe 05.
37	kod3	Numri amzë/NVAQ i personit juridik/fizik (garanti/bashkë-kërkuesi i kredisë). Në qoftë se nuk ka garant / bashkë-kërkuesi i kredisë, në këtë fushë vendoset: -1.	Po vetëm për tipat = 03, 04 dhe 05.
37-a	Nr.tat3	Numri tatimor i garantit / bashkë-kërkuesit të kredisë.	Po vetëm nëse kodi3 = -1.
38	titulli3	Titulli i garantit / bashkë-kërkuesit të kredisë.	Po vetëm nëse kodi3 = -1.
39	emri3	Emri i garantit / bashkë-kërkuesit të kredisë.	Po vetëm nëse kodi3 = -1.
40	Mbiemri3	Mbiemri i garantit / bashkë-kërkuesit të kredisë.	Po vetëm nëse kodi3 = -1.
40-a	Tipi	G - garant B - bashkë-kërkuesi i kredisë Ka të bëjë me të dhënat e fushës nr. 37, 37-a, 38, 39 dhe 40	Po vetëm nëse kodi3 = -1.
41	PDPërsh	Pozita e përshtatur devizore e klientit D – Pozita e përshtatur devizore N - Pozita e papërshtatur devizore Kjo fushë plotësohet përfundimisht me 30 nëntor 2014.	Po, vetëm për tipat = 03, 04 dhe 05.
41-1	PD e përsh	Pozita e përshtatur devizore e klientit. Gjatë plotësimit të kësaj kolone përdoren shifrat: D1 – eksportuesit neto;	Po, vetëm për tipat = 03, 04 dhe 05 edhe për përjashtimet e parashikuara në pikën

		D2 – personat juridikë të cilat çmimi i produktit më të shpeshtë varet nga lëvizshmëria e çmimit të këtij produkti në tregjet botërore; D – personat e tjerë juridikë dhe fizikë, me pozitë e përshtatshme devizore; N – personat juridikë dhe fizikë, me pozitë e papërshtatshme devizore. Kjo fushë plotësohet nga 1 dhjetor 2014.	29), paragrafi (6) të Vendimit për menaxhim me rrezikun kreditor.
42	kryegjëVP (3)	Kryegjëja në fund të muajit (në pajtim me Vendimit për plotësimin e Vendimin e standardeve supervizore për rregullimin e kërkesave të maturuara e jo të paguara të bankave dhe kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/98)).	Po
43	kamatëVP (4)	Kamata në fund të muajit (në pajtim me Vendimit për plotësimin e Vendimin e standardeve supervizore për rregullimin e kërkesave të maturuara e jo të paguara të bankave dhe kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/98)).	Po
44	Kërkesatëtj eraVP(5)	Kërkesa të tjera në fund të muajit (në pajtim me Vendimin për plotësimin e Vendimit e standardeve supervizore për rregullimin e kërkesave të maturuara e jo të paguara të bankave dhe kursimoreve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/98)).	Po
45	Ekspoziti përgjithVP	Ekspozimi i përgjithshëm: përmbledhja e shumave të fushave 42, 43 dhe 44.	Po
46	KryegjëjaK Ç (3)	Gjendja e kryegjëse së çregjistruar në fund të muajit. Nuk vendosen shuma të vogla të kërkesave individualisht të parëndësishme, në pajtim me rregullativën e Bankës Popullore për menaxhim me rrezikun kreditor.	Po, përveç për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
47	КаматаКЧ (4)	Gjendja e kryegjëse së çregjistruar në fund të muajit. Nuk vendosen shuma të vogla të kërkesave individualisht të parëndësishme, në pajtim me rregullativën e Bankës Popullore për menaxhim me rrezikun kreditor.	Po, përveç për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
48	дрПобарО П (5)	Gjendja e kërkesave të tjera të çregjistruara në fund të muajit. Nuk vendosen shuma të vogla të kërkesave individualisht të parëndësishme, në pajtim me rregullativën e Bankës Popullore për menaxhim me rrezikun kreditor.	Po, përveç për përjashtimet e parashikuara në kolonën 3.
49	Ekspoziti përgjithKЧ	Ekspozimi i përgjithshëm i çregjistruar: përmbledhja e shumave e fushave 46, 47 dhe 48.	Po
50	Emri i Cert.	Titulli i certifikatës i cili do të pranohet për vendosjen e të dhënave	Po
51	Tel	Telefoni për kontakt	Po

52	e-postë	Posta elektronike për kontakt	Po
----	---------	--------------------------------------	----

Shtojcë nr. 2

Shifrat për tregtarët në pakicë

kodi	Tregtarët në pakicë
1901	Bujqësi
1902	Tregti
1903	Veprimtari të tjera shërbyese
1904	Veprimtari të tjera

Shtojcë nr. 3

Shifra për qëllimin e kredive të personave fizikë/popullsinë

Kodi	Qëllimi
1801	Kreditë për blerjen dhe rinovimin e hapësirës banesore
18011	Kreditë për blerjen dhe rinovimin e hapësirës afariste
1802	Kreditë shpenzuese
1803	Tejkalimi i llogarive transaksione
1804	Kreditë në bazë të kartelave të dhëna kreditore
18041	Kreditë për vetura
1805	Kreditë e tjera

Shtojcë nr. 4

Shifra për llojin e sigurimit

Kodi	Lloji i sigurimit
001	Depozitë/depo në para
002	Garanci dhe letra me vlerë të lëshuara nga RM-ja
003	Letra me vlerë (me përjashtim të letrave me vlerë të lëshuara nga RM-ja)
004	Garancitë nga institucionet financiare
005	Garanci të dhëna nga personat juridikë
006	Hapësirë banesore si vendbanim dhe për dhënie me qira për banim
007	Hapësirë tjetër banesore
008	Hapësirë afariste
009	Hapësirë për magazinim
010	Kapacitete prodhuese
011	Pronë tjetër e paluajtshme
012	Mjetet motorike
013	Sende të tjera të luajtshme
014	Garantët dhe kambiale
015	Bashkëkërkuksi i kredisë
016	Sigurimi tjetër
017	I pasiguruar
018	Pengu i kërkesave nga Republika e Maqedonisë
019	Pengu i kërkesave, përveç kërkesave të Republikës së Maqedonisë

Shtojcë nr. 5

Shifrat e vendbanimit (komunës)

Kodi	Vendbanimi (komuna)
101	Haraçinë
102	Berovë
103	Manastir
104	Bogdanc
105	Bogovinjë
106	Bosillovë
107	Bërvenicë
108	Vallandovë
109	Vasilevë
110	Vevçan
111	Veles
112	Vinicë
114	Vrapçisht
115	Gjevgjeli
116	Gostivar
117	Gradskë
118	Dibër
119	Debërcë
120	Dellçevë
121	Demir-Kapi
122	Demir-Hisar
123	Dojran
124	Dollnen
126	Zhelinë
128	Zelenikovë
129	Zërnovc
130	Ilinden
131	Jegunovc
132	Kavadar
133	Karbinc
134	Kërçovë
135	Konçë
136	Koçaë
137	Kratovë
138	Kriva-Pallankë
139	Krivogashtan
140	Krushevë
141	Kumanovë
142	Lipkovë

143	Llozovë
144	Mavrovë dhe Rostushë
145	Makedonski Brod
146	Kamenicë e Maqedonisë
147	Mogillë
148	Negotinë
149	Novac
150	Novo-Sellë
152	Ohër
153	Petrovc
154	Pehçevë
155	Pllasnicë
156	Prilep
157	Probishtip
158	Radovish
159	Rankovc
160	Resnjë
161	Rosoman
162	Nagoriçan i Vjetër
163	Shën Nikollë
164	Sopishtë
165	Strugë
166	Strumicë
167	Studenica
168	Tearcë
169	Tetovë
170	Qendra e Zhupës
171	Çashkë
172	Çeshinovë dhe Obleshevë
173	Çuçer-Sandevë
174	Shtip
175	Aerodrom
176	Butel
177	Gazi-Babë
178	Gjorçe Petrov
179	Karposh
180	Kisella Vodë
181	Saraj
182	Qendër
183	Çair
184	Shuto-Orizarë
185	Qyteti i Shkupit